



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 498/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve të Kosovës (PAI), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me nr. A-498 dhe A-499, të datës 13.12.2010, të subjektit politik subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovë (PDAK) kundër Partia e Ashkalive për Integrim (PAI).

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa, me numër A-498 dhe A-499 paraqitur nga PDAK kundër subjektit politik PAI në të cilat pretendohet se :

Ka pasur parregullsi të shumta në Komunën e Ferizajt nga përfaqësuesi i subjektit politik PAI Qazim Rrahmani i cili gjatë tërë procesit parazgjedhor dhe zgjedhor ka bërë shkeljen e Kodit të Mirësjelljes duke iu ofruar votuesve para për të votuar dh duke përdorur fjalor fyes ndaj përfaqësuesve të PDAK-së. Përveç kësaj Qazim Rrahmani ditën e zgjedhjeve 12.12.2010 në shumicën e QV në qytetin e Ferizajt në fshatrat Zaskok dhe Pleshinë ka hyrë në QV –të dhe i ka penguar votuesit që të votojnë.

Në QV 1315E/01D në shkollën fillore “Vllëzërit Frashëri” në Lipjan rreth orës 08:00 antari i subjektit politik PAI , Adem Kryeziu ka votuar në 4 fletëvotime të cilat i ka futur në kuti të votimit. Në këtë rast ka reaguuar kryesuesi i këtij VV Adnan Ademi si dhe Organizata Monitoruese e Zgjedhjeve Demokracia në Veprim.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qellim të lehtësimit të shyrtimeve të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që përmbajnë në vetë çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik PDAK, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullësi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 498/2010 më datën 15.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

